



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIË**

Nr. 4043/prot.
2

Tiranë, më 05.07.2019

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1720, datë 19.06.2014.

SHOQËRISË “EDLA” SH.P.K

Ndërtesa Afër Njesisë Administrative Dajç, Kati I-rë, Fshati Dajç, Shkodër.

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.**

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “Edla” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1720, datë 19.06.2014, për mineral kromi, në objektin “Iballë”, Pukë, Qarku Shkodër.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresën nr.2591, datë 08.04.2019, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.4043 datë 10.04.2019, është propozuar revokimi i lejes nr.1720, datë 19.06.2014, për mineral kromi, në objektin “Iballë”, Pukë, Qarku Shkodër, sepse nuk keni paguar garancinë financiare të rehabilitimit të mjedisit për vitet 2017 – 2018, 2018 -2019 duke mos respektuar kërkesat e nenit 31 të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve, është i mbështetur në germën “ç” të pikës 1, të nenit 47, (neni që përcakton shkëljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1720, datë 19.06.2014, për mineral kromi, në objektin “Iballë”, Pukë, Qarku Shkodër, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes shfrytëzimit nr.1720, datë 19.06.2014, për mineral kromi, në objektin “Iballë”, Pukë, Qarku Shkodër.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

ME AUTORIZIM

ZËVENDËSMINISTRI

ILIR BEJTJA

